

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Bilanci i presidencës Begaj/ Gjenerali që u shkri si sheqeri
ADRESA	https://lapsi.al/bilanci-i-presidences-begaj-gjenerali-qe-u-shkri-si-sheqeri-i1094009
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 15:43:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 15:39:35 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b942be467938e598efca04fa3dee5497f5583b8402ea8c539aecc02afa708955
TEKSTI	51c943cd11e504283f718075ccaad469f1cc8167d2c5d69398c3bbe6d3049524
PAMJA	a63cdf25767d7ca859478d2fa8304abc77c923dd3075dba9251c07999e6c474b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7c6a17f168697a8456c452fc6b8a08a5b8922676082d1b295c40d03ed457b742
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/7c6a17f168697a8456c452fc6b8a08a5b8922676082d1b295c40d03ed457b742

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Bilanci i presidencës Begaj/ Gjenerali që u shkri si sheqeri

Ka nxituar të dekretojë në mëngjes një ligj të votuar në mesnatë. Po kjo nuk është shkeja e parë mbi reputacionin e postit që bën Bajram Begaj. Një retrospektivë katër vjecare e presidencës së tij



LAPSI.AL • 18 SEPTEMBER 2026



Sa më shumë kohë kalon, aq më tepër servilizmi proverbial i Bajram Begajt arrin të trondisë edhe më indiferentët. Kjo ka ndodhur edhe në kufirin e shkurtër mes mesnatës së mbrëmshme dhe mëngjesit të kësaj të premteje. Presidenti kukull ka thyer [do rekord të paradržësve të vet duke dekretuar sot ligjin kontrovers të pagave të magistratëve, që u votua nga mazhoranca vetëm pak orë më parë. Ky akt që e ka detyruar shefin e grupit parlamentar të opozitës, Gaz Bardhi ta etiketojë atë si "rojen e godinës së parlamentit" nuk u bë vetëm me urgjencë, por edhe pa dhënë një qëndrim të vetin. Kjo e ka yshtur Bardhin të deklarojë:

"Në këtë situatë, dekretimi i ligjit pa një qëndrim publik të Presidentit mbi përplasjen institucionale dhe mbi zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ngre pikëpyetje serioze mbi mënyrën se si po ushtrohet roli i tij kushtetues. Kushtetuta i ka dhënë një rol shumë më të rëndësishëm: të jetë mbi palët dhe të garantojë funksionimin kushtetues të shtetit. Për fat të keq, Presidenti i Republikës nuk perceptohet më si arbitër dhe garant i ekuilibrit kushtetues, por si një institucion që thjesht formalizon vendimmarrjen e mazhorancës".

Por ky është vetëm akti i fundit i sevilizmit, Gjenerali të cilin Rama e trehton si ushtar nuk ka folur asnjë fjalë për 111 ditë protesta në vend, ndërkohë që revolucion i flamingove ka tërhequr vëmendjen e mediave më të mëdha të botës dhe ka prodhuar rezoluta të Parlamentit Evropian.

Në afro katër vite Bajrom Begaj pothuajse e ka asgjësuar rolin e simbolit të unitetit të popullit duke u sjellë si një vegël qorre. Kështu ka ndodhur që nga vera e vitit 2022, kur ai u zgjodh me 78 vota, pothuajse të gjitha të koalicionit qeveritar.

Fillimisht meskiniteti i tij u pa në detaje të vogla, nga ato që kanë lidhje me protokollin. Askush se ka harruar se kur ish presidenti Bill Clinton erdhi në Tiranë, në korrik 2023

ide



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi

Andi Bushati



Gënjeshtër e rezortëve elitare

Blendi Kajsia

MOTITRANA

27°C

KËMBIMIEURO

91.54

aktuale

08:06

Seancë brenda, protestë jashtë/ Qytetarët zhvendosen para Kuvendit

08:02



Seancë maratonë në Kuvend/ Pesë interpelanca në rend dite, sot vendoset edhe për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndjeqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



presidenti i vendit mungoi në ceremoni. Ai ishte "harruar" të ftohej nga kryeministri organizator, i cili ndërkohë i pati rrëmbyer edhe kompetencën për të shpërndarë dekorata, duke i dhënë ish nismëtarit të çlirimit të Kosovës një medalje të shpikur prej tij, "Yllin e mirënjohjes". I turpëruar dyfish gjenerali nuk e hapi gojën. Vetëm pasi mediat e bënë shumë të zhurshëm këtë lajm, zyra e shtypit të presidencës njoftoi se mungesa justifikohet me "shkaqe mjekësore".

Ky nuk është rasti i vetëm. Sa herë i është dashur Ramës, Begaj është fshirë nga pjesëmarrja në takime apo samite ndërkombëtare. Ndonëse në traditën e diplomacisë shqiptare mbretëron një ligj i pashkruar, që vendi përfaqësohet në samitin e përvitshëm të OKB-së, një herë nga kreu i shtetit dhe një herë nga kryeministri, në shtator 2023, Begaj ia dogjën radhën pa i dhënë asnjë shpjegim.

Po kështu Rama e ka detyruar presidentin ti thotë jo ftesës së përbashkët të marrë nga princi i Emirateve të Bashkuara Arabe për samitin e klimës në nëntor 2024. Episodi më mbrslënës që ai i përkujtimet të 20 vjetorit të samitit historik të Selanikut, i cili i hapi rrugën drejt BE-së vendeve të Ballkanit Perendimor. Ai u zhvillua në kulmin e krizës mes Athinës dhe Tiranës, që pasoi burgosjen politike të kryetarit të zgjedhur të bashkisë Himarë, Fredi Beleri. Në mënyrë arrogante autoritetet greke nuk e ftuan kryeministrin Rama, të cilin e bënë përgjegjës për këtë makinacion politik. Qeveria Mitsotakis bëri të ditur se ky ishte një distancim politik dhe se si organizatorë ata do të ftonin presidentin Begaj.

Lexo më tej



22 GUSHT, 11:03

Komenti/ Ç'kuptuam nga "darka e gabuar" e Athinës

Ky i fundit, që nuk guxonte të shkonte përpara Ramës gjeti justifikimin më qesharak të mundshëm, që zor se ia besonin edhe familjarët e vet: e kishte "axhendën të ngjeshur". Por, roli i Begaj nuk ka shërbyer vetëm për të përmbushur vanitetin ndërkombëtar të Ramës, ai është përdorur edhe si vegël, për manovra meskine të brendëshme.

Në kulmin e krizës parlamentare kur opozita bllokoi për tre muaj parlamentin për arsye se asaj i ishte mohuar e drejta kushtetuese për të kërkuar ngritjen e komisioneve hetimore, kreu i shtetit u hodh në fushë si një zar në shërbim të mazhorancës. Duke e ditur shumë mirë se në kuvend nuk mund të mbahej seancë normale për shkak të kaosit të krijuar, ai u urdhërua me urgjencë të mbante një fjalë, në 15 janar 2024, përballë deputetëve. Natyrisht që nuk e bëri dot.

Por qëllimi ishte për të njoftuar PD-e cila jo vetëm PS-në por as presidentin nuk e lejon të flasë.

Lexo më tej



15 JANAR, 20:04

Fjalimi/ Bajram Begaj si kamikaz i qeverisë

Kjo u duk qartë nga interpretimi që i bëri ish kryetarja e kuvendit, Lindita Nikolli këtë incidenti: "I kërkojmë ndjesë presidentit të Republikës. Për shkak të situatës së krijuar nga deputetët e opozitës pamundësohet që qytetarët të ndjekin fjalën e tij nga Kuvendi", - u shpreh ajo. Megjithatë Begaj e mbajti fjalën e tij nga selia e presidencës ku nuk shqiptoi dot asnjë rrokje për respektimin e të drejtave të opozitës, por ku nuk harroi të fshikullojë atë: "Qytetarët shqiptarë presin të shohin një parlament funksional, dhe jo përplasje fizike në shtëpinë e demokracisë sonë". Lista e shërbesave meskine nuk ka fund.

Në maj 2023 parlamenti i kërkoi presidentit të dekretonte me procedurë urgjente, ligjin për rritjen e pagave të deputetëve dhe zyrtarëve të lartë. Ushtar i bindur, njësoj si tani me pagat e magistratëve, ai e zbatoi urdhrin me të parën, vetëm pasi vuri një kusht të



Gjykata ndërkombëtare bllokoi qeverinë Rama/ Pse nuk ndërhyu SPAK për aeroportin e Vlorës



"Të plasi trapi...", SMS-të e Ballukut në dosjen për aferën e Unazës së Tiranës



Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes-man-izmi



I mori Grudën FSHF-së, Klopp shpërthen për zbulimin e listës në media: "Është patetike të fitosh jetesën kështu"

vogel, ma s'mini për m'me paraqite se me vone d'netoj për në Gjermani. ma uje karagjozlëku nuk ka fund, ai ktheu përgjigje zyrtare se do të bënte një gjë të tillë, para se votimi të kryhej, ndonëse formalisht ende nuk dihej rezultati i tij.

Lexo më tej



25 MAR, 16:02

Dekreti urgjent/ Presidenti qesharak i një parlamenti të turpshëm

Begaj i ka shërbyer me zell edhe lojrave të vogla brenda klaneve të mazhorancës për të kontrolluar prej tyre segmente të drejtësisë. Tipike në këtë rast është përpjekja për të kapur edhe ato ishuj të pakontrollueshëm brenda Gjykatës Kushtetuese. Begaj me anë të një letre, në janar të këtij viti i ka kërkuar kësaj gjykate të interpretojë nëse tre nga mandatet e anëtarëve të saj duhet të mbyllen para mbarimit të afatit 9 vjeçar. Nën presionin e një militanti, Begaj shpërfilli edhe dekretin e parardhësit të tij, duke hedhur një hap që u pa me shumë shqetësim edhe në raport progresin e Bashkimit Evropian. Përfundimi u pa më vonë: një nga të vetmet gjyqtare që kishte vijuar në vijimësi kundër qeverisë, u largua nga detyra.

Lexo më tej



19 MAR, 14:08

Opozita akuzon presidentin Begaj dhe Sokol Sadushin për puç kushtetues

Ai veptoi po njësoj edhe kur Edi Ramës iu desh të bënte lojën me zgjedhje të parakohëshme në Tiranë pasi mori një kompetencë që sia një kushtetuta për të shkarkuar Erion Veliajn. Dekretimi i zgjedhjeve të parakohshme të Tiranës, për 9 nëntor 2025 u bë nga presidenti në kundërshtim me nenin 115 të ligjit themeltar të shtetit, që e pezullon procesin në rastet kur kryebashkiaku i shkarkuar ankohet në gjykatën kushtetuese. Vendimi i mëpasëm i kësaj të fundit tregoi se dekreti i Begajt ishte i gabuar.

Lexo më tej



1 TETOR, 19:29

Një president lolo

Pavarësisht nga këto, pavarësisht se autoritet i tij vijon të shpërbëhet si sheqeri në ujë, Bajrom Begaj nuk do ti dijë. Me një buzagaz naiv, fajëpak dhe me kokën ulur, më të njëjtin l'nderim me të cilin e kërkonte para Erdoganit për të zmadhuar zyrën, ai sillet edhe para Edi Ramës. Me sa duket nga vila 4 mbi kodër skrupujt moralë i duken të largëta, Ai kënaqet që ha e pi me paratë e shtetit, që kur udhëton ka në delegacion parukieren e gruas, që i hapin derën e veturës dhe shoqërohet me badigardë. Ti kërkojsh më tepër ndoshta është e pamundur për të. Ai e di më mirë nga të gjithë sepse ndoshta ngaqë është i tillë arriti dhe ta kapë atë post.

©Lapsi.al

Të kështilluara



Gjykata ndërkombëtare bllokoi qeverinë Rama/ Pse nuk ndërhyjnë SPAK për aeroportin e Vlorës

Urdhri i arbitrit të ICC-së frenoi qeverinë nga krijimi i një fakti të kryer në Aeroportin e Vlorës, duke mbrojtur përkohësisht jo vetëm interesat e MABCO-s, por edhe buxhetin shqiptar nga rreziku i një arbitrazhi me faturë prej qindra milionë eurosh.



Revolta në Driehtinë kënaqësi në Beograd/ Si u



Revista në Tiranë, kënaqesi në Beograd, ora prit dënimi me burg për ish-krerët e UÇK-së

Vendimi i Gjykatës Speciale për të dënuar me gjithsej 81 vite burg katër ish-drejtesit kryesorë të Ushtrisë Çli...



Nga torturat te vrasja e 96 personave/ Pse i dënoi Haga katër ish-krerët e UÇK-së



Trafiku i drogës, korrupsioni dhe projekti i Kushner, seancë dëgjimore në Kongresin amerikan, DASH mbështet SPAK

"Organizatat kriminale transnacionale që veprojnë në Shqipëri kanë lidhje me kartelet e drogës në Hemisferën Perëndimore"



"Diplomacia e dollarit" vjen në Shqipëri/ The New Yorker: Si u hapën dyert për Kushnerin

Jared Kushner me dorën e djathtë bën diplomaci, me të majtën bën biznes. Shqipërinë e kap me dorën e majtë.



Veliaj mbetet në burg/ Gjykata e Lartë e sheh si proporcional izolimin e tij?

Çdo të bëhet me qytetarët e Tiranës tani që psi për arsye të procesit Veliaj e futi Bashkinë në kaos. A do të vijojë të këmbëngulë ai që mos e delegojë sërish autoritetin dhe firmën dhe të shtirë si kryetar nga burgu?



Zgjerohet skandali i izraelitit Ron Yeffet, përgjimi: Shkoni në Vlorë dhe bëni çfarë të doni”



Rama lëshon Ballukun/ Top Channel nis sulmin: "Pse SPAK vonon kërkesën për arrestimin"

Pas muajsh heshtjeje dhe mbrojtjeje politike, sinjalet nga mediat pranë qeverisë dhe qëndrimi i ri i Edi Ramës tregojnë se Belinda Balluku mund të jetë lënë tashmë vetëm përballë SPAK -ut, në prag të një kërkesë të dytë për arrestimin e saj.



TV francez "C News": Shqiptarët po i bëjnë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.